

VENDIM
Nr. 148, datë 10.9.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
RREGULLORES MBI PROCEDURAT PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË
PËRJASHTIMIT PËR INFRASTRUKTURËN E RE TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 32, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 38, nenit 43, pika 1 dhe nenit 78, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 99/3, datë 3.9.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat për dhënie të së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror”,

konstatoi se:

- objektivi i kësaj rregulloreje është të sigurojë nxitjen e investimeve në infrastrukturën kryesore të re, duke garantuar funksionimin e tregut të gazit natyror;
- qëllimi i kësaj rregulloreje është: të përcaktojë rregullat për një procedurë përjashtimi transparente, jodiskriminuese dhe të arsyetuar, në përputhje me rregullat e Paketës së tretë të energjisë;
- procedurat që aplikohen për përjashtimin në këtë draftrregullore, janë bazuar në parashikimet e nenit 78, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar;
- kjo rregullore paraqet rregulla për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe procedura transparente për të shmangur çdo parregullsi për pasjen e një tregu transparent dhe konkurrues.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat për dhënie të së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti